



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Metodologji e kërkimit dhe mjeteve të përkthimit

Ngarkesa: 3 kredite, 15 leksione, 15 seminare

Viti / Semestri : Viti I, semestri II,

Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: Master Shkencor në Përkthim Teknik-Letrar dhe Interpretim

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Studentet njihen në rrafsh teorik e praktik me burimet kryesore elektronike që shërbejnë si instrumente të nevojshme në të gjitha fazat e procesit të përkthimit, që nga analiza e tekstit burimor dhe përcaktimi i tipologjisë së tij e deri tek produksioni/sintetizimi dhe redaktimi final i tekstit në gjuhën mbërritëse.

Ata pajisen në përfundim të kursit me një aparat ndihmës të mjeteve dhe instrumenteve elektronike më të përdorshme në praktiken përkthimore.

Objektivat specifike lëndore:

1. Studentët njihen me fjalorët dixhitalë online dhe fjalorët në mediume të tjera elektronike përveç internetit, me glosarët terminologjikë online.
2. Njihen me bazat elektronike të të dhënave për terminologjinë e fushave të ndryshme.
3. Mesojnë të punojnë me tekste paralele dhe mbi të gjitha “ku” dhe “si” ti gjejnë apo filtrojnë në internet tekstet paralele.
4. Bëhet një përjasje mes përkthimit human dhe atij automatik dhe u mësohet studenteve si të shfrytëzojnë sistemet elektronike të përkthimit automatik (Translation Memory Systems), si edhe mjetet e tjera online të përkthimit automatik.
5. Ata njihen me instrumentet elektronike të redaktimit të tekstit dhe me kompetencat e përpunimit elektronik të tij.